



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË



Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • **Tel:** ++355 4 222230; 222750; 235568
• **Fax:** ++355 4 223558 • **Website** www.bankofalbania.org • **E-mail:** public@bankofalbania.org

DEKLARATË PËR SHTYP

MBI NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË DHE ATË VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2004

14 TETOR 2004

1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

1.1 Operacionet e tregut të hapur

Situata e likuiditetit në tremujorin e dytë të vitit 2004 u karakterizua nga tepricë likuiditeti. Për manaxhimin e likuiditetit, Banka e Shqipërisë ndërhyri kryesisht me instrumentin kryesor të tregut në vlerë mesatare prej 3.4 miliardë lekë. Me qëllim drejtimin e nivelit të interesave të tregut ndërbankar dhe të *yield*-ve në nivelin e përcaktuar nga politika monetare, Banka e Shqipërisë kufizoi shumën e tërhequr në dy ankandet e fundit të marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor të këtij tremujorit.

Tabela e mëposhtme paraqet vëllimin (në milionë lekë) e likuiditetit të tërhequr nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur.

Data	REPO javore	REPO njëditore	REPO njëmujore
01.04.04	3,983.00		
08.04.04	5,040.00		
15.04.04	3,950.00		
22.04.04	1,545.00		
29.04.04	3,565.00		
06.05.04	3,120.00		
13.05.04	4,308.00		
20.05.04	2,950.00		
27.05.04	5,275.00		
03.06.04	2,600.00		

10.06.04	3,980.00		
17.06.04	2,000.00		
24.06.04	1,500.00		
25.06.04	1,500.00	6,003.00	
29.06.04	1,500.00		4,000.00

1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetës

Në mbështetje të instrumenteve të tregut të hapur, për investimin e likuiditeteve të lira bankat përdorën edhe depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 715 milionë lekë. Mungesa e likuditetit në ditë të veçanta, solli dhe përdorimin e kredisë njëditore, mesatarisht 98 milionë lekë në ditë.

2. NDËRHJRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

Gjatë tremujorit të dytë Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun e brendshëm valutor përmes ndërhyrjes aktive vetëm në ditët e fundit të muajit qershor. Kjo ndërhyrje ka ardhur si rrjedhojë e zhvillimeve në kursin e këmbimit të Lekut me monedhat USD dhe EUR dhe është realizuar përmes tërheqjes nga tregu i brendshëm valutor i monedhës EUR. Vëllimi total i hyrjeve në llogaritë Bankës së Shqipërisë në EUR deri në fund të muajit qershor nga veprimet e blerjeve është 3.345 milionë EUR ndërkohë që në sistemin bankar kanë kaluar rreth 410.51 milionë lekë.